

VENDIM
Nr.1066, datë 16.7.2008

PËR INTEGRIMIN E ISH-QENDRËS SË STUDIMEVE GJEORAFIKE, TË
AKADEMISË SË SHKENCAVE, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Integrimin e ish-Qendrës së Studimeve Gjeografike (QSGJ), në departamentin e gjeografisë, të Fakultetit Histori-Filologji, të Universitetit të Tiranës.

2. Pasuritë e luajtshme (burime financiare, automjete, donacione, projekte kërkimi dhe zhvillimi, orendi, infrastrukturë, pajisje informatike etj.), si dhe arkivat shkencore e çdo dokumentacion tjetër arkivor i ish-QSGJ-së, t'i kalojnë në administrim Fakultetit Histori-Filologji, të Universitetit të Tiranës.

3. Në departamentin e gjeografisë, të Fakultetit Histori-Filologji, të Universitetit të Tiranës, shtohen katër vende pune, për personelin akademik të ish-QSGJ-së.

4. Marrëdhëniet e punës së këtyre punonjësve rregullohen me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe me Kodin e Punës.

5. Niveli i pagave të personelit akademik të ish-QSGJ-së, do të jetë i njëjtë me atë të personelit akademik të Universitetit të Tiranës.

6. Numri i personelit akademik, shtesë në departamentin e gjeografisë, të Fakultetit Histori-Filologji, të Universitetit të Tiranës, të jetë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve, të miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2008, në ministrinë dhe institucionet qendrore”, të ndryshuar.

7. Për periudhën nga 1.1.2008 deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të gjithë punonjësit e ish-QSGJ-së trajtohen nga Universiteti i Tiranës si punonjës me kontratë të përkohshme.

8. Për punonjësit, që pas riorganizimit humbasin vendet e punës, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha